



## **Republika e Kosovës**

Republika Kosova-Republic of Kosovo

## **Qeveria –Vlada-Government**

**Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)**

Univerziteteska Bolnička i Klinička Služba Kosova (UBKSK)

Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

### **Rregullore nr. 1001/2016**

**Për veshjen dhe dukjen e të punësuarëve në të gjitha institucionet  
shëndetësore të SHSKUK-së**

Kjo Rregullore do të zbatohet në të gjitha njësitë përbërëse organizative të SHSKUK-së

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Statutit të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, nenit 45 pika 3 të Ligjit të Shëndetësisë së Kosovës nr.04/L-125, nenit 95 të Ligjit të punës nr. 03/L-212, Bordi Drejtues i SHSKUK-së në mbledhjen e mbajtur me: **08.08.2016** miraton këtë:

## **RREGULLORE PËR VESHJEN DHE DUKJEN E TË PUNËSUARVE NË TË GJITHA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE TË SHSKUK\_së**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Rregullorja për veshjen dhe dukjen e të punësuarëve në insitucionet publike shëndetësore të SHSKUK-së ka për qëllim të përcaktojë rregullat e veshjes dhe dukjen e të punësuarëve gjatë orarit të punës.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimi**

Dispozitat e Rregullores për veshjen dhe dukjen e të punësuarëve në insitucionet publike shëndetësore të SHSKUK-së janë të obligueshme për të gjithë të punësuarit në institucione shëndetësore të SHSKUK-së.

### **Neni 3**

Veshja dhe dukja e të punësuarëve duhet të jetë serioze dhe t'i përgjigjet vendit dhe natyrës së punës që kryen.

### **Neni 4**

Të punësuarit, me veshjen dhe dukjen e tyre, gjatë kohës sa gjenden në detyrë zyrtare, duhet të përkujdesen për paraqitjet e tyre, të cilat korrespondojnë me ruajtjen e autoritetit personal dhe të institucionit që e përfaqësojnë.

### **Neni 5**

Të punësuarëve, nuk u lejohen veshje, të cilat mbajnë një mesazh vullgariteti, joshjeje ose të turpshme.

### **Neni 6**

#### **Veshja dhe dukja e të punësuarëve në institucionet publike shëndetësore**

6.1. Veshja e të punësuarëve duhet të mbulojnë pjesën më të madhe të kraharorit;

6.2. Veshjet në përgjithësi, nuk duhet të jenë aq të lira dhe të hapura sa të ekspozojnë trupin ose veshjet e brendshme;

- 6.3. Veshjet e pjesës së poshtme të trupit për femra duhet të jenë në nivel të gjatësisë adekuate (fustan, fund deri në gjunjë);
- 6.4. Nuk lejohet që të duket trupi ndërmjet veshjeve të larta dhe të poshtme;
- 6.5. Nuk lejohen pantallonat e shkurtra;
- 6.6. Nëse mbahet rrip, ai duhet të jetë në gjatësinë dhe gjerësinë e përshtatshme;
- 6.7. Mustaqet, zylyfet, llojet e ndryshme të mjekrave, lejohen vetëm nëse mbahen të pastra dhe të prera mirë;
- 6.8. Nuk lejohen kapelet jo shëndetësore, syzet e diellit, gjatë procesit të punës;
- 6.10. Nuk lejohet veshja e rrobave të tejdukshme, me gjinse të përditshme, veshjet sportive, veshjet tepër të shkurtëra ose tepër të gjata, veshjet me rripa, dekolte tepër të thella, grim i tepërt, mbathjet sportive dhe të kohës së lirë (sandalet, papuçet e të ngjashme), mbathjet me take tepër të larta, apo ndonjë mënyrë tjetër ekstravagante e veshjes që nuk është e përshtatshme;
- 6.11. Veshjet e të punësuarve nuk duhet të përmbajnë fotografi dhe shkronja.
- 6.12. Të punësuarit duhet të kujdesen për higjienën personale dhe paraqitjen e jashtme.
- 6.13. Mund të barten vetëm unazat e martesës dhe një palë vathë diskret nga ari apo argjendi, stolitë dhe format e tjera të stolive që shpojnë trupin ndalohen dhe nuk duhet të mbahen.
- 6.14. Të punësuarve u ndalohet rritja, mbjellja e thonjëve si dhe ngjyrosja me ngjyra të theksuara dhe dizajnimi i tyre.
- 6.14. Veshja e të punësuarëve meshkuj, për pozicionet drejtorë dhe funksionet të tjera më të larta në hierarki se ky pozicion, preferohet të jetë me kostum, këmishë e kravatë apo ekuivalente.
- 8.14. Veshja për të punësuarat femra, për pozicionet drejtoreshë dhe funksionet të tjera më të larta në hierarki se ky pozicion duhet të jetë serioze, jo ekstravagante me funde shumë të shkurtra apo këmisha e bluza dekolte.
- 8.15. Mospërfillja e rregullave të veshjes dhe dukjes së shërbyesëve publikë përbën shkelje të rregullave të Kodit të mirësjelljes dhe Rregullores për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale.

## **Neni 7**

Nëse i/e punësuar/i vishet në kundërshtim me rregullat e veshjes dhe dukjes, duhet ndjekur hapat si në vijim:

1. Udhëheqësi i drejtpërdrejtë në bisedë me të punësuarin/en, duhet t'ia tërheqë vërejtjen me gojë se veshja dhe dukja e tillë është në kundërshtim me rregullat e veshjes dhe dukjes së të punësuarëve.

2. Në rast të mospërfilljes së vërejtjes dhe vazhdimit të veshjes dhe dukjes në kundërshtim me rregullat, udhëheqësi i drejtpërdrejtë i bënë vërejtje me shkrim.
3. Në rast të mospërfilljes së vërejtjes me shkrim dhe në rast të përsëritjes së sjelljes së tij, inicohet procedura disiplinore.

#### **Neni 8**

1. Për zbatimin e rregullave të veshjes dhe dukjes së të punësuarëve janë përgjegjës:
  - 1.1. Udhëheqësit më të lartë të institucioneve,
  - 1.2. Udhëheqësit e drejtpërdrejtë të të punësuarëve.

#### **Uniformat për punëtorët shëndetësor**

##### **Neni 9**

1. Qëllimi primar i uniformës është identifikimi dhe mbrojtja e punëtorëve shëndetësor.
2. Uniforma paraqet veshjen e cila bënë dallimin profesional të punëtorëve shëndetësorë:
  - 2.1. Uniforma bazë për stafin medicinal është mantili i bardhë dhe
  - 2.2. Uniformat e bardha (bluza, pantolonat dhe kllompet).

##### **Neni 10**

#### **Uniformat për shërbimet specifike shëndetësore**

Uniformat për shërbimet specifike janë:

- 10.1. sallat operative – uniforma e gjelbërt;
- 10.2. punëtorët e higjienës – të kaltërta (teget) dhe
- 10.3. shërbimet teknike – ngjyrë hiri.

##### **Neni 11**

#### **Rrobat mbrojtëse**

Rrobat mbrojtëse nuk janë uniformë, por vishen si shtesë apo në vend të uniformës, në rast të rrezikut të madh dhe të ketilla janë:

- Mantelet laboratorike
- Rrobat për sallë të operacionit;
- Përparëset dhe dorëzat
- Syzet dhe maskat.

##### **Neni 12**

#### **Parandalimi i infeksionit**

1. Me qëllim të parandalimit të infeksioneve uniforma lejohet të ndërrohet më shpesh, respektivisht në baza ditore.
2. Uniformat e papastërta dhe të kontaminuara me gjak apo lëngje trupore duhet të ndërrohet menjëherë.
3. Pastrimi dhe larja e uniformave bëhen në lavatoren e spitalit.

### **Neni 13**

1. Personeli i veshur me uniformë mund të qarkullojë brenda hapsirave të institucionit dhe oborrit të institucionit.
2. Uniformat nuk guxojnë të vishen jashtë objekteve shëndetësore.
3. Rreptësisht ndalohet bartja e uniformës jashtë oborrit të institucionit.

### **Neni 14**

#### **Kartela e identifikimit**

1. Kartela e identifikimit duhet të mbahet nga të gjithë të punësuarit gjatë gjithë kohës për qëllime sigurie në spital.
2. Kartelat tjera të lejuara janë, ajo e anëtarësisë në trupat profesionale apo kartela e anëtarësisë në sindikatë.

### **Neni 15**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Bordit Drejtues të SHSKUK-së.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

  
Curr Gjocaj

